

KALENDARI I PUNIMEVE TË KOMISIONIT TË POSAÇËM PËR REALIZIMIN E REFORMËS ZGJEDHORE

(ngritur me vendimin e Kuvendit nr. 74, datë 27.10.2025)

I. Hartimi i projektligjit të ri “Për financimin e partive politike”

Nr.	Çështja	Afati
1.	Hartimi i projektligjit “Për financimin e partive politike”	30 dhjetor 2025

* Në mesin e muajit Dhjetor 2025 do të organizohet nga Komisioni një tryezë diskutimi me partitë politike, organizatat jofitimprurëse, organizatat ndërkombëtare në Shqipëri në fushën e demokracisë dhe zgjedhjeve, ekspertë dhe akademikë për diskutimin e projektligjit. Në këtë tryezë do të ftohen të marrin pjesë ekspertë të ODIHR dhe Komisionit të Venecias.

II. Hartimi i Kodit të ri Zgjedhor

Nr.	Tema dhe Çështje	Afati
1.	- Dispozita të përgjithshme: objekti, përkufizime dhe parime për zgjedhjet e përgjithshme dhe vendore. - Zgjedhësit dhe përgatitja e listës së zgjedhësve.	Janar 2026
2.	- Regjistrimi i subjekteve zgjedhore, - Rregjistrimi i kandidatëve, - Zonat zgjedhore - Numri i mandateve për çdo zonë.	Shkurt 2026

3.	Përgatitja e listës së zgjedhësve, administrimi dhe numërimi i votave të shtetasve shqiptarë me banim jashtë Republikës së Shqipërisë.	Shkurt 2026
4.	Kufizimet dhe/ose ndalimet e parashikuara për përdorimin e burimeve shtetërore në zgjedhje.	Mars 2026
5.	Institucionet për përgatitjen dhe administrimin e zgjedhjeve: - Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve; - Komisionet e nivelit të parë të Administrimit të Zgjedhjeve; - Komisionet e nivelit të dytë të Administrimit të Votimit. Infrastruktura e zgjedhjeve: - Organizimi i infrastrukturës së zgjedhjeve; - Përgatitja e dokumentacionit zgjedhor dhe dërgimi i materialeve zgjedhore; - Votimi, përfshirë edhe votimin e zgjedhësve brenda vendit që nuk kanë mundësi paraqitje në qendrën e votimit; - Kushtet për administrimin e votimit dhe rezultati zgjedhor; - Teknologjia në zgjedhje, pilotimi, garancitë e votimit dhe të procesit të numërimit; - Transparenca e veprimtarisë së KQZ-së dhe organeve të tjera.	Prill 2026
6.	Fushata zgjedhore, monitorimi i fushatës zgjedhore dhe fushata zgjedhore në media audiovizive dhe në mediat sociale, si dhe ndalimet përkatëse. Financimi i zgjedhjeve dhe i fushatës zgjedhore: - financimi i zgjedhjeve; - financimi i subjekteve zgjedhore, përfshirë palët e treta. - financimi i kundërligjshëm i zgjedhjeve dhe financimi i fushatave zgjedhore nga burime të huaja.	Maj 2026
7.	- Ankimi administrativ, - Hetimi administrativ, - Ankimi gjyqësor, - Sanksionet	Qershor 2026

8.	Çështje të tjera për zgjedhjet, përfshirë sistemin zgjedhor, në varësi dhe te ndryshimeve eventuale të ndarjes së re administrative-territoriale. Komisioni mund të vendosë me konsensus për diskutim edhe çështje të tjera që lidhen me zgjedhjet.	Nëntor 2025- Korrik 2026
9.	Hartimi i dispozitave sipas këtij Kalendar mund të kërkojë ndërhyrje legjislative në ligje të tjera si Kodi Penal, ligje të tjera, etj.	Nëntor 2025 – Korrik 2026
10.	Miratimi në tërësi i projektligjit “Kodi Zgjedhor” dhe eventualisht i projektligjeve të tjera të lidhura me të.	Korrik 2026

* Afatet kohore janë indikative dhe mbeten në varësi të çështjeve në diskutim dhe kohës së hartimit të dispozitave normative.

SHËNIM:

1. Projektligji duhet të depozitohet në Kuvend sipas afatit të parashikuar në vendimin e Kuvendit nr. 74, datë 27.10.2025.
2. Grupi i Ekspertëve Teknikë harton tekstin e dispozitave të reja të projektligjit sipas Kalendarit dhe ia paraqet ato për diskutim dhe miratim në Komisionin e Posaçëm për realizimin e Reformës Zgjedhore. Në përfundim të mbledhjes së Komisionit reflektohen në tekstin e dispozitave përkatëse amendamentet e dakortësuara.
3. Në vijim teksti i dispozitave të miratuara publikohet në faqen e internetit të Kuvendit dhe njëkohësisht ftohen të gjithë të interesuarit të paraqesin mendimet dhe sugjerimet e tyre në emailin e Sekretarisë së Komisionit të Posaçëm. Një kopje elektronike i dërgohet elektronikisht edhe OJF-ve vendase për të paraqitur komentet dhe vërejtjet e tyre në lidhje me to.
4. Komisioni mund të zhvillojë konsultime, dëgjesa dhe tryeza me organizata ndërkombëtare, partitë politike, OJF vendase për çështje të caktuara që përfshihen në këtë kalendar pune.
5. Teksti i dispozitave të miratuara i dërgohet për mendim edhe ODIHR dhe Komisionit të Venecias dhe eventualisht organizatave të tjera ndërkombëtare për ekspertizë. Në mënyrë të veçantë në rast se në Komisionin e Posaçëm nuk ka dakortësi politike për një çështje apo dispozita të caktuara, Komisioni në mënyrë konsensuale, i drejtohet për mendim këshillimor ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias duke i paraqitur çështjen për të cilën nuk ka dakortësi politike dhe eventualisht çdo material apo koment të anëtarëve në lidhje me të.